Kronikë

Mori peng avokaten dhe e kërcënoi me armë sportive në zyrë, nis hetimi për 74 vjeçarin në Korçë! Dvorani: Shkak procesi i zgjatur gjyqësor

Një 74 vjeçar është vënë nën hetim nga policia e Korçës nën akuzën se ka mbajtur peng dhe ka kërcënuar me armë sportive avokaten, Entela Dvorani brenda zyrës së kësaj të fundit.

Lajmi i fundit

E rëndë në Shkup, të mitur abuzojnë seksualisht me 8-vjeçarin! E incizojnë dhe ua dërgojnë shokëve

30 Prill, 22:36

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
28 Prill, 13:37 | Përditësimi: 28 Prill, 20:40

Ndiqe

Një 74 vjeçar është vënë nën hetim nga policia e Korçës nën akuzën se ka mbajtur peng dhe ka kërcënuar me armë sportive avokaten, Entela Dvorani brenda zyrës së kësaj të fundit.

Ka qenë një proces gjyqësor i tejzgjatur arsyeja për këtë akt të rëndë të ndodhur ditën e djeshme. Kështu u shprehën edhe avokatja Dvorani e cila ka bërë edhe një kallëzim në polici për të moshuarin që po hetohet në gjendje të lirë.

LEXO EDHE:
Meta në Pustec me kandidatin Pandi Jani: Zona do të transformohet në një model të zhvillimit të qëndrueshëm

Në një deklaratë për mediat ajo u shpreh se prej vitit 2015, klienti i saj ndodhet në një proces gjyqësor për pronën, process që prej vitit 2016 kaloi në shqyrtim në Gjykatën e Lartë por ende nuk ka pasur një seancë ku të jepet vendimi përfundimtar.

Teksa mëfeu tmerrin e përjetuar, Dvorani tha se Çango e kishte mbajtur të mbyllur brenda zyrës së saj për 5 orë deri në mbërritjen e policisë. Ndërsa shtoi se i moshuari e kishte kërcënuar me jetë sepse nuk kishte pranuar ti firmosë një shkresë jo ligjore dërgjuar gjykatësi të Gjykatës së Lartë që kishte në doré dosjen e Çangos. Ndërsa i dha të drejtë këtij të fundit për kërkesën e tij.

> *"Ndërkohë prona e tij është e uzurpuar, e kanë zënë njerëz të tjerë. Ai ka të drejtën e pronësisë. Koha e gjatë e pritjes në gjykatën e Lartë solli atë revansh nga ai. Ai ka ardhur edhe herë të tjera dhe ka pyetur cili gjykatës e ka në doré. Pas pandemisë është rënduar, bëri edhe një operacion në zemër. Mua për atë klient më vjen keq edhe për atë stres që ka kaluar më vjen shumë keq"- shtoi avokatja.*

Ajo tha se të gjithë personat që ofrojnë shërbime publike, duhet të kenë mbrojtje nga policia në mënyrë që raste të tilla të mos përsëritshin.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 16:46

Me pistoletë sportive kërcënoi me armë avokaten brenda zyrës së saj, publikohet foto e 74 vjeçarit në Korçë

Ky është 74 vjeçari Nikollaq Çango i cili me një armë sportive ka kërcënuar me jetë avokaten Entela Dvorani në Korçë për një shkresë që kjo e fundit nuk kishte pranuar ta firmosë pasi ishte jo ligjore.

Mësohet se shkak për aktin e rëndë të kryer nga i moshuari, është bërë zgjatja me 7 vite e procesit gjyqësor mbi pronën e tij.

Ora 16:27

U mbajt peng nga 74 vjeçari në zyrën e saj, avokatja: Më tha do të vras se nuk i jepja shkresë jo ligjore! Zgjatja e procesit gjyqësor solli këtë situatë

Avokatja, Entela Dvorani e cila u mor peng brenda zyrës së saj për 5 orë nga një 74 vjeçar, u shprehë për mediat se i gjithë konflikti kishte ardhur pasi klienti i saj i kishte kërkuar të bëntë një kërkesë jo ligjore dreçi Gjykatës së Lartë ku po shqyrtohej dosja e tij.

Ajo tha se Nikollaq Çango e kishte kërcënuar me jetë dhënë e djeshme, me arsyetimin se kjo e fundit nuk po i përmbushte kërkesat e tij.

> *"Ai kërkoi nga unë dje t'i bëja një kërkesë siç do ai diçka jo ligjore. Gjë që nuk mund ta bëja, se një avokat nuk e bën. Ai e kishte bërë vetë dhe e kishte dërguar tek gjykatësi i cili me të drejtë ma ktheu mua. Ndërkohë zotëria erdhi dje dhe më thoshte shkruaje si të them unë me armë në doré. Më goditi në gjoks. Më thoshte unë do të vras, ti je kokfortë, ty nuk të mbushet mendja të bësh atë që të them unë. Por unë nuk mund të bëj një kërkesë jo ligjore. Ka qenë vetëm një vit klienti im, nga 2014 deri në 2015 më pas në 2016 çështja kaloi në Gjykatën e Lartë"-u shprehë Dvorani.*

Sa i takon çështjes gjyqësore të 74 vjeçarit, avokatja tha se pa të drejtë i kishin uzurpuar pronën dhe se i gjithë shpërthimi i tij kishte ardhur si pasojë e procesit gjyqësor të tejzgjatur nga Gjykata e Lartë.

> *"Ndërkohë prona e tij është e uzurpuar, e kanë zënë njerëz të tjerë. Ai ka të drejtën e pronësisë. Koha e gjatë e pritjes në gjykatën e Lartë solli atë revansh nga ai. Ai ka ardhur edhe herë të tjera dhe ka pyetur cili gjykatës e ka në doré. Pas pandemisë është rënduar, bëri edhe një operacion në zemër. Mua për atë klient më vjen keq edhe për atë stres që ka kaluar më vjen shumë keq"- shtoi avokatja.*

B.V/Shqiptarja.com

TAG: Entela Dvorani | Korçë | Nikollaq Çango

Komento

Komente

Mic 29/04/2023 02:50

7 vite nuk eshte asgje,neve na u desh 30 vjet veprime ligjore vetem qe te kalonim nje prone ne emerin tone sepse gjysh nuk kishte lene testament.Perpecite ishin kalvarjo duhej gjetur mos kishte lene testament te dyte,si mos kishte ndonje femija,a grua te padekleluar ne Shqiper,Greqi e U.S.A,po vertetime qe trashegimtaret kishin lidhje gjaku e ishin gjese e trungut familjar,po vertetim qe gjyshi ishte nje e i vetmi person,pasi dilte me 2 emra nje shqiptar,nje te amerikanizuar,pasi ishte shtetasi amerikan,po vertetim shtetasia,po trashegimtaret qe kishin vdekur nuk kishin lene pasardhes,etLpor te mos fokur per dokumentet qe duhesin perkthyer e noterizuar,fotokopjuar,duhesinin vazhdimisht data te reja dhe vula te thata e te njomaJo vertetimi i pagremt te taksave per pronen,etj e kerkesa te tjera qe s'kishin fund dhe te gjitha keto kerkoheshin ne Greqi qe t'i vertetonte pala shqiptare,mnagjino te keshi proces ne Shqiperi si ky fakt,rpe perveo burokracine ruhme t'a zvarrisin edhe per ndonje zhvatje te vogel!!!

Përgjigju

Ndalohet reprodhimi i kësaj shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
1 maj, a respektohen të drejtat e punëtorëve në Shqipëri?

Po | Jo | Nuk kam mendim

Lajme të tjera

Kur libri 'troket në derë', biblioteka shëtitëse prek realitete të largëta gjatë Panairit në Korçë! Stendat plot në Gjytezën e Fëmijëve, shkrimtari: Si prind u befasova!

Anila Dedaj

29 Prill, 15:27

Kandidati i PS-së për Korçën, Sotiraq Filo takim me banorët në Moravë: Fshati do të ecë me ritme më të shpejta në mandatin e ri

29 Prill, 12:14

FRPD akuzon kryebashkiakun Filo për shpërdorim të 3.6 mld lekë: Erdhi koha të largoheni

29 Prill, 12:11

Me pistoletë sportive kërcënoi me armë avokaten brenda zyrës së saj, publikohet foto e 74 vjeçarit në Korçë

28 Prill, 16:46

U mbajt peng nga 74 vjeçari në zyrën e saj, avokatja: Më tha do të vras se nuk i jepja shkresë jo ligjore! Zgjatja e procesit gjyqësor solli këtë situatë

28 Prill, 16:27

Filo me banorët e Korçës: Pista e skive në Vithkuq, mundësi për zhvillimin e turizmit

28 Prill, 10:32

Goditi me mjete të forta në kokë një 37-vjeçar, shpallet në kërkim 54-vjeçari në Maliq

27 Prill, 11:34

Kandidati i PS në Pogradec takohet me artistët: Do i marrim bashkë vendimet për mirën e qytetit

27 Prill, 09:31

'14 maj!/' Kandidati i PS në Korçë takim me banorët: Kemi gati projekte madhore që rrisin ekonomitë! Duhet të dalim me sukses që të vijojmë punën

27 Prill, 08:53

Kriza ekonomike dhe papunësia, shqetësimi kryesor i korçarëve! Problem edhe kriminaliteti! Trafiku nuk konsiderohet

26 Prill, 21:06

Kërcënoi Eris Çekanin dhe i përplasi makinën me 'Hummer', arrestohet 30-vjeçari në Pogradec! Vëllezërit bashkëpunëtorë në kërkim

26 Prill, 11:35

'Vendoret'/ Kandidatët për bashkitë e vendit në terren, Socialistët: Do punojmë për turizmin! BF: S'kanë mbajtur premtimet

26 Prill, 08:24

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje